

BAHRI ALIU

SHQIPËRIA PËRJETON DITË TË VËSHITIRA

Prej 16 deri më 21 nëntor 1991, një delegacion i BI të RM, në përbërje të Kryetarit të BI në RM h. Sulejman ef. Rexhepi, Kryetarit të Kuvendit të BI në RM z. Enver Ferati, Drejtorit të Medresesë “Isa Beu”, Bahri ef. Aliu dhe Sekretarit të BI të Këshillit të BI të Strugës, Mushteba ef. Shehu, e vizitoi Shqipërinë.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri delegacioni mori pjesë në shënimin e përvjetorit të hapjes së xhamisë së Plumbit në Shkodër. Me ç’rast zhvilloi bisedime me Kryetarin e Bashkësisë Islamike Shqiptare rreth aktiviteteve të të dy Bashkësive Islamike. Mes tjerash u vu në pah edhe bashkëpunimi reciprok. Fatkeqësisht nga Kryetari i BISH u potencia vetëm nevoja e ndihmave nga jashtë.

Kryetari i BI në RM, shprehu gadishmërinë që të ndihmojë simotrën e saj, posaçërisht në kuadro të nevojshëm për të shërbyer në xhami si dhe për të mëkëmbur punën edukativo – arsimore të medreseve të posahapura në Shqipëri dhe ndihmat të marrin karakterin e obligimit Islam. Sa për informim përmendi se BI e Maqedonisë ka ndërmarrë disa aktivitete konkrete: në shtyp ka dorëzuar disa tituj të cilat i dedikohen BISH dhe besojmë se së shpejti ky edicion fetarë do të gjendet në çdo familje muslimane në Shqipëri; Shoqata Kulturore Humanitare “El-Hilal” ka tubuar ndihma, të cilat së shpejti do të arrinë në Shqipëri, por për shkaqe administrative në mes dy shteteve deri më tash nuk janë realizuar.

Delegacioni i BI të RM gjatë vizitës së vet që ia bëri Shqipërisë këmbëu edhe mendime me udhëheqës të shquar të partive politike shqiptare. Në vazhdim do t’i veçojmë disa prej tyre.

Boshllëku i besimit – shkas i kriminalitetit

Të hënën, me 18 nëntor, u takua me Kryetarin e Partisë Republikane Shqiptare, z. Sabri Godon, i cili pasi e informoi në pika të shkurtëra për programin e kësaj partie opozitare, mes tjerash bëri vërejtje se delegacioni po e viziton Shqipërinë në një kohë shumë të vështirë. Këto vështirësi u paraqiten brenda një viti edhe pse nisën kanë nga sistemi monist komunist – bolshevik. Mirëpo duke u bazuar në ndryshimet ekonomike besojmë se shumë shpejtë këto vështirësi do t'i tejkalojmë dhe se me siguri do të ngadhënjëjmë. Krahas vështirësive që i trashëguam nga ish sistemi, ne sot ballafaqohemi edhe me boshllëkun e besimit të cilin partia dhe Enveri u munduan ta çrrënjosin. Pëkundrazi boshllëku i besimit sot në Shqipëri është shkas i kriminalitetit. Mu për këtë ne si Parti Republikane institucionet fetare i kemi priur krahhapur dhe kemi borxh që me ata të punojmë për qëllime të ërbashkëst sptërrore dhe humane, m njëfjalë – për të miën e populli. Lirih ju themi se zyrëne PR konsideroni si një xhami në Tiranë, por edhe në vendet tjera në Shqipëri.

Qeveria heshtazi ka avansuar kishën Katolike

Të njëjtën ditë delegacioni, u takua, gjithashtu, me Sekretarin e përgjithshëm të Partisë Social Demokrate Shqiptare, z. Lucian Bashkkurti i cili informoi shkurtimisht se programi i partisës tyre është i njëjtë me atë të partive simotra në Evropë. Kjo Parti – vazhdoi ai – vepron si parti opozitare, mirëpo zë një numër të konsiderueshëm të vendeve në Qeveri. Kemi marrëdhënie të mira me PASOK-un e Greqisë, me socialdemokratët e Gjermanisë dhe me socialdemokratët e Maqedonisë, në veçanti potenciam çeshtjen e shqiptarëve në Jugosllavi duke e njohtuar se partia e jonë e njeh Kosovën sovranë si dhe respektojmë të drejtat e shqiptarëve të Maqedonis si qytetarë të barabartë me popujt e kësaj republike dhe se ndryshe nuk mund të mendohet statusi i tyre.

Gjatë dekadave të kaluara na ka munduar e drejta dhe liria e besimtarëve në Shqipëri. Enveri Shqipërinë e izoloi nga Perëndimi, Lindja, Veriu dhe Jugu, mirëpo Shqipërinë e izoloi edhe nga qilli sa që veten dhe Partinë i shpalli për zot të Shqipërisë. Andaj, ju keni ardhur në një kohë shumë të vështirë në Shqipëri, por duhet ta dini se populli ka nevojë për ndihmë. Ardhja e juaj në veçanti duhet të ngjallë besimin te rinia. Poashtu duhet t'i kushtoni rëndësi meremtimeve dhe rindërtimit të objekteve fetare Islame, sepse, si duket, Qeveria heshtazi ka avansuar Kishën Katolike. Kjo s'na pengon, mirëpo dua të them se popullatën shqiptare mbi 75% e përbëjnë muslimanët ndaj, Qeveria BISH duhet t'ia shtrijë dorën e ndihmës. Kuptohet sa ka mundësi, por kët gjer më tani se ka bërë.

Shqipëria ka nevojë për literaturë. Këtë duhet ta kuptoni si realitet, sepse sot në Shqipëri nuk kemi kuadro që do ta plotësonin këtë nevojë, por edhe sikur të kishte kuadro, nuk ka mjet për botimin e literaturës. Krahas kësaj në bahkëpunim me BISH duhet të krijoni kushte për hapjen e medreseve në Shqipëri.

Shqipëria – bastion i komunizmit

Të martën me 19 nëntor, në hotel “Tirana” delegacioni uhvilloi bisedime me z. Arben Puto, Kryetar i Forumit për të drejtat e qytetarëve dhe deputet i Parlamentit shqiptar. Z. Arben Puto e informoi për orintimet kryesore të Forumit. Mes tjerash përmendi se qëllimi ynë është që kushtet nëpër burgje të përmirësohen që deri më tash shumë pakë janë përmirësuar. Shqipëria ka

qenë bastion i komunizmit, sistemit bolshevik enverian. Këtë e vërteton fakti i tëdhënave dhe gjurmimeve të gjertanishme. Gjer më tani kemi hasur më se 300.000 proçese gjyqësore individuale. Këtë numër shumzoni me tre anëtarë të familjes mestarae, do të vimë në përfundim se më se gjysma e popullatës shqiptare ka qenë e dënuar, e internuar ose e arrestuar. Ne jemi të interesuar për rehabilitimin dhe reintegrimin kësaj popullate në jetën e

përditshme. Mirëpo, për ta realizuar këtë na duhen mjete. Për këtë qëllim presim ndihma nga jasht bile nga vëllezërit tanë në diasporë. Sa për ilustrim po ju informoj se Norvegjia është e para që do të na ndihmojë për këtë me 3 – 3.5 milionë dollarë.

Na vjen keq që ende nuk kemi vënë kontakte me forumet e shqiptarëve jasht Shqipërisë, por them se fajet janë të dyanshme dhe besoj se së shpejti do të kemi kontakte reciproke. Ne, gjithashtu, jemi të interesuar të kem kontakte të mira edhe me Bashkësinë Islame të Shqipërisë dhe besoj se me një aktivitet dhe informim të drejtë do t'i vënin kontaktet që gjer tani kanë qenë diku ose prej dikuj të ndërprera. Na vjen tepër keq që nuk kemi momentalisht në Shqipëri një kuadër i ri i cili besoj se do t'i përgjigjej kohës aq më tepër rrethanava tona. Këtë e potencoj posaçërisht sepse duke bisduar me ju mendoj edhe për ndihmën e BI të Maqedonisë në këtë drejtim.

Në mbrëmje të 19 nëntorit, në hotel “Dajti” delegacionin e priti z. Agim Zeka, ministër. Pritja e tij qe pritje vëllazërore. Kjo shihej nga biseda që zhvillohej dhe interesimi i z. Agimit për hallet tona.

z. Agim Zeka që në fillim u interesua për hallet dhe dertet e shqiptarëve jasht atdheut duke nënvizuar në veçanti se Shqipëria krahas peripetive, skamjes, përplasjeve partiake mendon për gjendjen e shqiptarëve në botë, posaçërisht në shtetet fqinje. Mendoj se me zgjedhjet e reja me siguri do të vijnë në pushtet forcat demokratike me plotëkuptimin e fjalës dhe vetëm ashtu do të mund të shpejtojmë proceset demokratike brenda në Shqipëri por edhe jasht. Për nder të delegacionit të BI-së në RM, z. Agim Zeka shtroi darkë solemne në Hotel “Dajti” dhe biseda u zhvillua pranë sofrës në një frymë të pastër vëllazërore.

Jemi për bashkëpunim

Në mëngjes të 20 nëntorit delegacioni u takua me Emin Musliun, ministër i ndërtimit. Në bisedë e sipër kryetari i Meshihait të BI të Maqedonisë,

shprehu dëshirë qëbashkësisë tonë t'i mundësohet të ketë përfaqësinë e vetë në Shqipëri që do të ishte në interes të dy bashkësve. Z. Emini shprehu gadishmërinë që BI të Maqedonisë t'i jepet vend që të ndërtojë selinë e vet, atje ku do t'i konvenojë më së miri në Tiranë. Lirisht mund të prgaditni projektin – tha në vazhdim – si ju përgjigjet juve. Ne jemi të gatshëm të bashëpunojmë në çdo lëmi. Mirëpo si duket, në këtë drejtim, ngec puna sidomos kur është në pyetje interesi i muslimanëve. Këtë nuk e them pa bazë, na kënaq gjendja mirë e katolikëve dhe e ortodoksëve, por pse vallë të mos përmirësohet edhe gjendja e muslimanëve. Më se 75% të popullatës e përbëjnë muslimanët, mirëpo për fat të keq sistemi enverian i ka shkatërruar. Po, na harroi. Juve nuk do ju besohet se kah fundi i vitit 1940 në Shqipëri ka pasur më se 1127 xhami, e tani ku janë?!

Maqedonia është e intresuar të vë marrëdhënie tregtare e në këtë ktekst të ndërtojmë edhe rrugën tregtare Durrës – Elbasan – Strugë. Ne jemi të gatshëm për një bashkëpunim të ndërsjellë që do të jetë në interes të të dy palëve. Nuk do të dëshironim që ky projekt të dështojë për çeshtje të pazgjidhura politike.

Femrës shqiptare t'i kthehet roli i saj

Delegacioni i BI zhvilloi bisedime edhe me delegacionin e Shoqatës së Gruas Shqiptare të cilin e kryesoi Kryetareja, zonja Diana Çuli dhe znj. Flutura Greva, Kryetare e Shqatës së Gruas Islamike Shqiptare.

Znj. Diana e informoi delegacionin për qëllimet dhe pogramin e SHGSH – së. Ajo posaçërisht e vuri në pah të kaluarën e hidhur të femrës shqiptare, qoftë si nënë, grua, motër, vajzë apo në fund të fundit si njeri me të vërtetë sistemi komunist e deformoi femrën shqiptare edhe fizikisht. Të harrojmë të kaluarën, të mundohemi ta harrojmë, të vetëdijshëm për vështirësitë që na presin në këtë aspekt. Qëllimi kryesor i SHGSH është dhe do të mbetet që gruas t'ia kthejë rolin e vërtetë ashtu siç i ka hije asaj, që ajo të integrohet në jetën e përditshme dhe të jep kontributin e vet në çdo pore të jetës. Për të

arritur këtë na nevojiten ndihma edhe nga ana e juaj. Juve, ndoshta, nuk ju besohet se momentalisht te ne ekziston një gjendje shumë e vështirë. Prandaj, juve mos habiteni nëse ju parashtrijmë shumë kërkesa. Por të bindeni se kërkesat tona janë nevojë e patjetërsueshme. Kemi nevojë për gjithçka, duke filluar prej bukës e gjer te edicioni fetar. Jo rastësisht ju drejtohem juve, në ju kemi besim dhe jemi të bindur se do të na ndihmoni me sinqeritet.

Znj. Flora Greva në fjalën e vetë në veçanti u ndal në mënyrën e organizimit të gruas muslimane pasi, siç tha, ne i kemi harruar format e organizimit në mënyrën Islame. Është fakt se ne gjer më tani nuk kemi pasur kontakt edhe me BI shqiptare, por ju premtijmë se në të ardhmen, nëse paraqitet nevoja do t'iu imponohemi për bashkëpunim. Nëse bashkësitë tjera fetare në Shqipëri, vërtetë nuk janë më të organizuara, këtu është znj. Diana, le të demantojë këtë.

Shoqata e gruas muslimane shqiptare vepron në suaza të Shoqatës së Gruas Shqiptare. Prandaj na intereso i të parshtrijmë pyetjen se si lindi ideja për formimin e një shoqate të këtillë, mu në Shqipëri.

Znj. Flutura na tha se duke u nisur nga fakti se më se 75% të popullatës e përbëjnë muslimanët, menduam se është më se e nevojshme që në kuadër të SHGSH të veprojë edhe SHGI. Këtë ide e përkrahën të gjitha shoqet që ishin prezente pavarësisht nga përkatësia fetare.

BI në Maqedoni e përmbanë populli

Kryetari i Meshihatit të BI-së h. Sulejman ef. Rexhepi, në krye të delegacionit, në të gjitha takimet i njohtoi thelbësisht nikoqirët për aktivitetet e BI në Maqedoni. Në fillim i njohtoi për sistemin e organizimit të punëve në BI duke filluar prej organeve bazë të këshillave të xhemateve, këshillave të BI të rretheve, Meshihatit të BI si organ ekzekutiv republikan, Kuvendit të BI, si organ më i lartë legjislativ republikan gjer te Kuvendi suprem i BI në nivel federativ.

Duke u nisur nga fakti se BI te ne ka vepruar në mnënyrë të organizuar edhe gjatë sistemit monist mendojmë se i kanë kryer obligimet e veta aq sa i kanë lejuar kushtet dhe rrethanat. Mirëpo, në fakt BI në Jugosllavi si duket ka qenë e vetmeja Bashkësi Islame në këto troje të Evropës.

Në kohën e fundit, edhe pse thirremi në demokraci, puna në BI dalngadalë po vështirësohet edhe atë më tepër nga faktorët e jashtëm se sa nga ato të brendshëm. Përkundër kësaj ne kemi menduar edhe forma të tjera të organizimit të punës dhe jemi më se të bindur se me kontributin e besimtarëve do t'i rrimë besnik Islamit dhe në të njejtën kohë dhe vetë organizatës. Para se të përmendi format e aktiviteteve mendoj se është e rrugës që në fillim të përmendi se BI në Maqedoni është shumë nacionale. Më se 80% të popullatës së kësaj bashkësie e përbëjnë shqiptarët. Krahas tyre BI e përbëjnë edhe turqit, torbeshët, Muslimanët, romët etj.

Bashkësinë Islame kryekëputë e përmbanë populli edhe atë me anë të të dhënave fetare, siç është zeqati, sadakatul-fitri, lëkurat e kurbanëve dhe ndihmat vullnetare. Në këtë mnënyrë BI ka mundur të formojë fonde të posaçme për të zhvilluar aktivitetet e veta.

Në kuadër të BI momentalisht funksionon medreseja "Isa Beu" në Shkup, e cila prej kur filloi të punojë, 1984, jep rezultate të dukshme në përgaditjen e kuadrove fetare. Krahas medresesë së shpejti do të fillojë të funksionojë edhe biblioteka Isa Beu, e cila momentalisht posedon një fond bukur të mirë të librave, por mendojmë se një pjesë e madhe librash të vjetra që gjendet në pronën private të besimtarëve do të lehet vakuf.

Edhe Shoqata humanitare kulturore "El-Hilal" vepron në suaza të BI dhe ka ndërmarrë një sërë aktivitete për t'u ndihmuar besimtarëve të trevave tona. Ajo ka tubuar mjaftë ndihma edhe për besimtarët e Shqipërisë por shkaqet administrative në mes dy shteteve nuk kemi mundur t'i jellim këtu dhe t'ua ndajmë vëllezërve tonë.

BI në Maqedoni nuk ka stagnuar as në çështjen e botimeve. Prandaj do të mundohemi që përmes institucioneve tona të botojmë edhe tituj tjerë të

rëndësishëm. Për sa u përket nevojave të vëllezërve tonë në Shqipëri ne kemi dorëzuar në shtyp pesë tituj më të rëndësishëm që kryekëputë iu dedikohet muslimanëve të Shqipërisë.

BI e Maqedonisë është e gatshme që të ndihmojë përkohësisht edhe në kuadrot profesionale. Mirëpo, si duket pengesat në këtë aspekt janë më tepër subjektive nga BI Shqiptare. Jo rastësisht në vitin 1991/92 pranuan një paralele nga Shqipëria për t'u shkolluar në Medresenë "Isa Beu" në Shkup, por për fat të keq nxënësve nuk iu mundësohet të sigurojnë vizat hyrëse për në Maqedoni nga ambasada serbosllave në Tiranë.

Besojmë se në të ardhmen do të konsulidohemi edhe më tepër si BI dhe në bashkëpunim me BI shqiptare do t'ia dalim në krye që me të vërtetë t'i shërbejmë pikë së pari njeriut që nënkupton në veçanti edhe besimtarin. Mirëpo, edhe ne në Maqedoni kemi problemet tona të përditshme qoftë në kuptimin nacional qoftë në atë fetarë. Insha-All-llah "demokacia" do t'i zgjidh këto probleme. Por, të jemi të vetdijshëm se të gjitha këto probleme duhet t'i zgjidhim me punë të zellshme e vetmohuese, e jo duke pritur nga të tjerët.

Delegacioni i BI në Shqipëri vizitoi edhe ushtruesin e detyrës së ambasadorit jugosllav në Tiranë, me ç'rast deshti të intervenojë drejtpërsëdrejti për nxënësit nga Shqipëria. Mirëpo, fatkeqësisht, biseda u zhvillua në nivel miqësor dhe mbeti vetëm në premtime e shpresa, ndërsa sot e kësaj dite nxënësit nga Shqipëria nuk arritën në medresenë "Isa Beu".

Në fund na mbetet vetëm të falenderojmë z. Xhevat Alibalin për mikpritjen që na e bëri.